

# Tax Alert

# PwC Albania

July 2022



**PwC**

# PwC Albania – Tax Alert

July 2022

**Amendments to the National Accounting Standard no. 15, "On Accounting and financial reporting of economic micro-units (NAS 15)" have entered into force (by Order no. 165, dated 13.6.2022).**

Among others:

This Standard will be applied by all economic entities classified as micro-entities, by law 25/2018, "On accounting and financial statements".

The definition of micro-unit according to NAS 15 is removed. According to this change, micro-units with a turnover of less than ALL **5 million** must also submit the financial statements in simplified form

This standard will be applied to financial statements covering the accounting period beginning on or after **1 January 2022**. The amendments adopted in April 2022 should be applied prospectively from 1 January 2022, without changing the comparative financial statements of 2021, which have been prepared according to existing accounting requirements.

**Source:** Official Gazette ([Link](#))

**As of 1 July 2022, active businesses cannot issue invoices that are not fiscalized**

The taxpayers falling under the small business (no VAT) category, are reminded to begin the fiscalization process. As of July 1, businesses that have not been fiscalized, are subject to **penalties**.

Taxpayers must apply online to be equipped with the electronic certificate of fiscalization, through the electronic service in e-Albania.

Taxpayers that are not subject to value added tax, are subject to simplified income tax on small businesses, do not have more than one location of business activity, have the legal status "Natural Person" and fall within the category of "Self-employed" persons, can use the Self-Care platform for FREE.

As for taxpayers who are not included in the above categories, the list of software companies certified by AKSHI and DPT for Fiscalization, can be found [here](#).

**Source:** General Directorate of Taxation ([Link](#))

Korrik 2022

**Ndryshime të Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 15, "Për Kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike (SKK 15)" hyjnë në fuqi (me Urdhër nr. 165, datë 13.6.2022).**

Ndër të tjera:

Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike të klasifikuara mikronjësi, nga ligji 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Përkufizimi i mikronjësive sipas SKK15 hiqet. Sipas këtij ndryshimi, Mikronjësitë me qarkullim më të ulët se **5 milion Lekë** duhet gjithashtu të dorëzojnë pasqyrat financiare në format të thjeshtuar.

Standardi do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël, që fillon më ose pas datës **1 janar 2022**. Ndryshimet e miratuara në prill 2022 duhet të zbatohen në mënyrë prospektive nga data 1 janar 2022, pa ndryshuar pasqyrat financiare krahasuese të vitit 2021, të cilat janë përgatitur sipas kërkesave ekzistuese të kontabilitetit.

**Burimi:** Qendra e Botimeve Zyrtare ([Link](#))

**Nga data 1 korrik 2022, bizneset, që ushtrojnë aktivitet nuk mund të lëshojnë fatura të pafiskalizuara**

Administrata Tatimore rikujton tatimpaguesit e biznesit të vogël pa TVSH, të pafiskalizuar brenda 30 qershorit të fiskalizohen, pasi nga 1 korriku bizneset, që nuk janë fiskalizuar do të përballen me **penalite**.

Tatimpaguesit duhet të aplikojnë online për t'u pajisur me certifikatën elektronike të fiskalizimit, përmes shërbimit elektronik në e-Albania.

Tatimpaguesit që nuk janë subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, kanë përgjegjësi tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, nuk kanë më shumë se një vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, kanë statusin ligjor "Person Fizik" dhe kategorinë e punësimit "I vetëpunësuar i vetëm", mund të përdorin FALAS platformën Self-Care.

Për tatimpaguesit, që nuk përfshihen në kategoritë si më lart, lista e kompanive softuerike të çertifikuara nga AKSHI dhe DPT për Fiskalizimin mund të gjendet [këtu](#).

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ([Link](#))

**As of 10 August 2022, invoices with status “submitted” will automatically change to status “received”**

New developments in the fiscalization system enable that invoices with the status "submitted" will automatically change to status "accepted", starting from August 10, 2022, and being implemented for each subsequent month.

Taxpayers who have not yet taken any action for electronic purchase invoices (acceptance/rejection), are impacted. GDT requires that all relevant verifications for purchase invoices are made on time, as at the moment of switching to the LIVE environment, these invoices will be automatically accepted.

**Source:** General Directorate of Taxation ([Link](#))

**VAT declaration, sales/purchase books will continue to be submitted via e-filing**

GDT informs taxpayers subject to VAT, that the submission of the VAT declaration and sales and purchase books will continue to be carried out through the electronic declaration account in e-filing.

Sales and purchase book entries will continue to be submitted manually, with the possibility of verifying the data of fiscalized invoices and correcting inaccuracies, meanwhile the VAT Declaration will be filled manually in e-filing.

Invoices issued and fiscalized through the Central Invoice Platform will be the only valid tax documentation.

The accurate and correct completion of the sales and purchase books and the timely declaration of VAT is the responsibility of the taxpayer.

**Source:** General Directorate of Taxation ([Link](#))

**Nga data 10 gusht 2022, faturat me status “dorëzuar” do të kalojnë automatikisht në statusin “pranuar”**

Zhvillimet e reja në sistemin e fiskalizimit mundësojnë që faturat me status “dorëzuar” do të kalojnë automatikisht në statusin “pranuar”, duke filluar nga data 10 gusht 2022, e duke u zbatuar për çdo muaj në vazhdim.

Janë të prekur tatimpaguesit të cilët ende nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për faturat elektronike të blerjes, (pranim/refuzim). DPT kërkon të kryhen verifikimet përkatëse për faturat e blerjes, pasi në momentin e kalimit në ambientin LIVE, këto fatura do të pranohen automatikisht.

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ([Link](#))

**Deklarata e TVSH, librat e shitjes/blerjes do të vijojnë të kryhen nëpërmjet e-filing**

DPT informon tatimpaguesit, subjekt i TVSH, se dorëzimi i deklaratës së TVSH-së dhe librave të shitjes dhe blerjes do të vijojë të kryhet nëpërmjet llogarisë së deklaramit elektronik në e-filing.

Regjistrimet e librave të shitjes dhe blerjes do të vijojnë të dorëzohen manualisht, duke patur mundësinë e verifikimit të të dhënave të faturave të fiskalizuara si dhe korigjimin e pasaktësive, ndërsa deklarata e TVSH-se do të plotësohet manualisht në e-filing.

Faturat e lëshuara dhe të fiskalizuara nëpërmjet Platformës Qendrore të Faturave do të jenë dokumentacioni i vetëm i vlefshëm tatimor.

Plotësimi i saktë dhe korrekt i librave të shitjes dhe blerjes dhe deklarimi i TVSH-së në kohë është përgjegjësi e tatimpaguesit.

**Burimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ([Link](#))



# Let's talk


## Contact us for more information:

PricewaterhouseCoopers Albania  
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: [al\\_pwc\\_albania@pwc.com](mailto:al_pwc_albania@pwc.com)

Web: [www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al)



**pwc**

